

Përshëndetje! Ky mesazh trajton temën e etheve te fëmijët. Unë ju jap këshilla rreth gjërave që mund të bëni kur keni ethe dhe se kur i nevojitet një fëmije mjeku apo mjekja.

Një fëmijë ka ethe kur ka një temperaturë trupi mbi 38,5 gradë Celsius. Te fëmijët poshtë 3 muajsh nga 38 gradë Celsius. Kur ka ethe, fëmija ka faqe të kuqe dhe ballë të nxehtë. Shpesh ai ka tështitje ose një simptomë tjetër. Por, ethet më së shumti nuk janë të rrezikshme. Ato e ndihmojnë trupin për t'u shëruar.

**Me këto 5 këshilla mund ta ndihmoni fëmijën tuaj kur ka ethe:**

1. Jepni fëmijës suaj të pijë shumë ujë dhe çaj. Për foshnjat e sapolindura, qumësht gjiri ose qumësht pluhur.
2. Lejoni fëmijën tuaj të flejë shumë gjumë.
3. Visheni fëmijën vetëm hollë. Mos e mbuloni.
4. Për fëmijët ka medikamente të veçanta kundër etheve. Pyetni në farmaci se cilat medikamente përshtaten për fëmijën tuaj.
5. Kushtojini fëmijës suaj shumë vëmendje. Për shembull, ju mund të lexoni diçka për fëmijën tuaj.

**A jeni të pasigurt nëse ju duhet të shkoni me fëmijën tuaj te një meke apo mjek? Në këto 8 situata një fëmijë ka nevojë për një mjek apo mjek:**

1. Fëmija ka ethe dhe është më i vogël se 3 muajsh.
2. Ethet nuk përmirësohen pas 4 ditësh.
3. Ethet nuk mund të ulen me medikamente.
4. Fëmija është shumë i lodhur. Ai pothuajse nuk reagon fare dhe është shumë e vështirë për ta zgjuar fëmijën.
5. Fëmija nuk pi dhe nuk ka pelena të lagura.
6. Fëmija nuk mund ta përkulë më kokën përpara ose reagon ndjeshëm kur preket.
7. Fëmija pëson shpërthim puçrrash me pika të kuqe. Ato nuk mund të shtypen.
8. Fëmija ka të dridhura ethesh. Muskujt tërhiqen, fëmija është pa ndjenja ose ka sy të shtrembëruar.

Nuk jeni të sigurt se çfarë duhet të bëni? Pyetni te qendra e këshillimit për prindër ose në pediatri. Të gjitha adresat dhe numrat e telefonit i gjeni në [www.meinkindistkrank.ch](http://www.meinkindistkrank.ch)

Ju uroj të gjitha të mirat juve dhe fëmijës suaj!